



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 nëntor 2013
Nr.ref.:RK503/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI86/13

Parashtrues

Malush Krusha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në
Prishtinë, Rev. nr. 157/2011, të 4 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Malush Krusha nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin në Gjykatë e përfaqëson Bujar Krusha, nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 157-2011, të 4 prillit 2013, që i është dorëzuar parashtruesit të kérkesës më 15 maj 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kérkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 4 prill 2013, është vërtetimi i së drejtës së pronësisë për pronën.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 21.4, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 paragrafin 2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 17 qershor 2013, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe e njëjta u regjistrua me numër KI86/13.
6. Me vendim të Kryetarit, Nr. GJR. KI 86/13, të 20 qershorit 2013, gjyqtari Altay Suroy u emërua Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me vendim të Kryetarit, Nr. KSH. KI86/13, u emërua edhe Kolegji shqyrtyues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 2 korrik 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kérkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kérkesës.
8. Më 13 shtator 2013, Kolegji shqyrtyues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përbledhja e fakteve

9. Më 15 qershor 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë miratoi kérkesëpadinë e paditësve I. Xh. dhe S. Xh. nga Gjakova dhe nxori Aktgjykimin [C. nr. 263/05], me të cilin vërtetohet se paditësja I. Xh. është pronare e $\frac{1}{4}$ pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr. 1098/1. Me të njëtin aktgjykim, Gjykata e obligoi të paditurin (parashtruesin e kérkesës) që t'iа njohë këtë të drejtë dhe të lejojë që paluajtshmëria e lartpërmendor të regjistrohet në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, në emër të paditëses.
10. Gjykata Komunale më tej vërtetoi se S. Xh. është pronar i ngastrës kadastrale nr. 1098/2, dhe bartës i së drejtës për shfrytëzim të përhershëm. Gjykata i obligoi të paditurit G. K., N. Q., E. K., B. K., V. N., N. A., B. K. që paditësit t'iа njohin këtë të drejtë dhe të lejojnë që paluajtshmëria në fjallë të regjistrohet në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në emër të paditësit.

- a. Gjykata Komunale në dispozitiv të aktgjykimit theksoi se gjatë procedurës, me rastin e paraqitjes së dëshmive dhe dëgjimit të dëshmitarëve, është konstatuar se z. D. B. K., (tani i ndjerë) ka qenë pronar i ngastrës nr. 1098, me sipërfaqe 0.10,72 ha, dhe se pas vdekjes së tij, në procedurën e trashëgimisë, bijve të tij, H. K. dhe SH. K., u ka takuar nga $\frac{1}{2}$ pjesë ideale, dhe se në bazë të ndarjes fizike, ishin formuar ngastra të reja me numër 1098/1 (që i ka takuar të birit H. K.), dhe nr. 1098/2 (që i ka takuar të birit tjetër, SH. K.).
- b. Pas vdekjes së H. K., me Aktvendimin e trashëgimisë T. nr. 62/60, ngastrën 1098/1 e trashëguan të bijtë e tij, A. K., G. Z., I. Xh., si dhe e bija N., e cila në ndërkojë ka ndërruar jetë, ndërsa pjesën e saj të pronës e trashëguan të bijtë, B. K. dhe Sh. Xh., të cilët në procedurë të trashëgimisë janë shpallur trashëgimtarë të $\frac{1}{2}$ pjesë ideale të paluajtshmërisë së lënë nga paraardhësi i tyre ligjor.
- c. Gjykata Komunale në bazë të shkresave të lëndës që kishte në dispozicion, konstatoi se në bazë të kontratës [leg. nr. 6/67], që në shkresat e lëndës evidencohet si kontratë për ndarje, e 30 janarit 1967, A. K. (i ati i parashtruesit të kërkesës, i cili është pasardhës i të ndjerit H. K., i cili nga ana e tij ka qenë pasardhës i parë i D. B. K., dhe që kishte marrë ngastrën nr. 1098/1) dhe parashtruesi i kërkesës e ndanë tërë paluajtshmërinë e evidentuar si ngastra nr. 1098/1 dhe ngastra nr. 1098/2, që të dyja me sipërfaqe prej 0.10,72 ha.
- d. Në rastin konkret, Gjykata Komunale konstatoi se kontrata [leg. nr. 6/67], si e tillë nuk ka bazë ligjore përfaktin se A. K. nga paluajtshmëria ka marrë sipërfaqe më të madhe, gjë që nuk ka mundur t'i takojë në bazë të ligjit (do të thotë se i njëjti i ka marrë në tërësi ngastrat kadastrale nr. 1098/1 dhe nr. 1098/2, në sipërfaqe totale prej 0.10,72 ha), edhe pse në fakt nuk i ka takuar më shumë se $\frac{1}{4}$ pjesë ideale e ngastrës kadastrale nr. 1098/1, ZK Gjakovë-qytet, në bazë të Aktvendimit të lartpermendur të trashëgimisë [T. nr. 62/60].
- e. Qëndrimi i Gjykatës Komunale ishte se kontrata e lidhur për ndarjen [Leg. nr. 6/67], e 30 janarit 1967, nuk kishte kurrfarë baze ligjore, gjë e cila sigurisht nuk prodhon efekt juridik në kontestin lëndor dhe nuk ka fare ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështjeje.
- f. Gjykata Komunale në aktgjykim konkludoi „*se pretendimet e të autorizuarit të parashtruesit, se parashtruesi i kërkesës të drejtën e përhershme të shfrytëzimit të të dy ngastrave të lartcituarë e ka fituar në bazë të Vendimit të trashëgimisë T. nr. 33/97, të cilit i ka paraprirë një kontratë e lidhur mes tij dhe babait të tij që në vitin 1967, pjesërisht qëndrojnë dhe atë vetëm përmasën prej $\frac{1}{4}$ të pjesës ideale të ngastrës kadastrale me nr. 1098/1, ZK Gjakovë-qytet, për arsyen se paraardhësi i tij juridik (duke u bazuar nga Aktvendimi T. nr. 62/60), ka mundur të bartë tek i ati (tek i ati i parashtruesit të kërkesës), ndërsa i ati (i ati i parashtruesit të kërkesës) ka mundur të bartë në këtu të paditurin (parashtruesin) vetëm $\frac{1}{4}$ pjesë ideale të ngastrës kadastrale me nr.*

1098/1, ZK Gjakovë-qytet, ndonëse vetëm në këtë pjesë ideale ka qenë pronar „de lege“ dhe „de facto“, dhe pikërisht këtu vjen në shprehje parimi i mirënjojohur juridik se: “askush nuk mund të tjetërsojë – bart në tjetrin më shumë të drejta sesa ka vetë”.

11. Më 28 korrik 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë [Cv. nr. v263/05], të 15 qershorit 2009. Në arsyetim, parashtruesi theksoi se gjatë procedurës pranë Gjykatës Komunale kishte pasur shkelje esenciale të dispozitave procedurale, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe kësisoj i propozoi gjykatës që të anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.
12. Më 10 dhjetor 2012, Gjkata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 352/09], me të cilin e refuzon ankesën e parashtruesit, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë [C. nr. 263/05], të 15 qershorit 2009, e vërteton në tërësi.
13. Në arsyetim, Gjkata e Qarkut theksoi: „*Gjkata e Qarkut ka gjetur se gjykata e shkallës së parë me nxjerrjen e provave të nevojshme drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe me vlerësimin e drejtë të provave e ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpacia e paditësve është e bazuar dhe në aktgjykim ka dhënë arsyet e mjaftuara juridike dhe faktike për faktet relevante të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë*“.
14. Më 19 janar 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [C. nr. 263/05] dhe të Gjykatës së Qarkut në Pejë [Ac. nr. 352/09].
15. Më 4 prill 2013, Gjkata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 157/2011], me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion.
16. Gjkata Supreme në aktgjykim theksoi se „*ka shqyrtauar aktgjykimet e goditura të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut në kuptim të nenit 215 të Ligjit, dhe se ka gjetur se kërkesa e parashtruesit për revizion është e pabazuar.*“

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pohon se „*sipas dispozitës së nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit. Çdokush gjzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim.*“
18. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se gjatë procedurës pranë gjykatave është shkelur parimi themelor i trajtimit të barabartë të palëve në procedurë.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe se kjo gjendje është vërtetuar vetëm në bazë të deklaratës

së palës kundërshtare. “Në atë kontest mua nuk më është mundësuar deklarimi dhe vërtetimi i fakteve se unë jam i vetmi trashëgimtar i tani të ndjerit babait tim, A.K., nga Gjakova”.

20. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese

„Që Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, Ac. nr. 352/09, të 31 janarit 2011, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 352/09, të 19 prillit 2011, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 157/2011, të 4 prillit 2013, t'i anulojë si vendime jo të ligjshme, e në bazë të të cilave mua më janë shkelur në mënyrën më flagrante të drejtat e mia të parapara me Kushtetutën e Kosovës“.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të qenë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili thotë se:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

23. Përveç kësaj, Gjykata ka parasysh edhe rregullin 36 (1)c) të Rregullores së punës, i cili parashev se:

“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse... kërkesa është qartazi e bazuar”.

24. Edhe pse parashtruesi i kërkesës ka theksuar se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet e Republikës së Kosovës, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë provë apo fakt relevant që do të tregonte se organet gjyqësore i kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë (Shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendim i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
25. Gjykata Kushtetuese rikujton se në bazë të Kushtetutës nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e apelit në raport me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
26. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe procedurat pranë gjykatave të rregullta në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit

Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

27. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit që ka paraqitur parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundim se procedurat dhe vendimet e gjykatave të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrale (Shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendim i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
28. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se pse dhe si i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Vetëm deklarimi se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Prandaj, në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 36 paragrafi (1) c) të Rregullores së punës, më 13 shtator 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

